

LIGJ
Nr. 19/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NË LIDHJE ME PROGRAMIN
E SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE UNIVERSITARE NË EVROPËN QENDRORE
“CEEPUS IV”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore “CEEPUS IV”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 98, datë 5.3.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
**NË LIDHJE ME PROGRAMIN E SHKËMBIMIT TË EVROPËS QENDRORE PËR
STUDIMET UNIVERSITARE (“CEEPUS IV”)**

Palët kontraktuese të CEEPUS-it ndajnë vizionin e mëposhtëm:

- ndjekjen e së vërtetës, rolin thelbësor të shkencës në krijimin e qytetërimit dhe transmetimin e njohurive nga brezi në brez si një veprimtari tejet e nderuar njerëzore;
 - shkëmbimin akademik rajonal si një instrument të rëndësishëm për të sfiduar stereotipat e ndërsjellë,
 - bashkëpunimin akademik afatgjatë nëpërmjet rrjeteve universitare me tematikë specifike të një cilësie të lartë, duke ofruar kuadrin e duhur për lëvizshmërinë e studentëve, studentëve të doktoratës, kërkuesve, mësuesve akademikë dhe personelit universitar;
 - avancimet në njohjen e periudhave të studimit jashtë shtetit, si edhe kualifikimeve të arsimit të lartë ndërmjet universiteteve dhe nxitjen e zhvillimit të dimensionit të kurrikulës universitare të Evropës Qendrore;
 - nxitja e bashkëpunimit rajonal në fushën e arsimit të lartë brenda sistemit të Programit të Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studimet Universitare, i referuar si CEEPUS IV.
- Palët kontraktuese janë angazhuar ndaj:
- rolit kyç që arsimi i lartë luan në përmbushjen e Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara;
 - synimeve të procesit të Bolonjës dhe Komunikatave të tij përkatëse, duke kontribuar në këtë mënyrë në realizimin e mëtejshëm të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë,
 - dhe morën në konsideratë:

- Kuadrin Strategjik të Zonës Evropiane të Arsimit për edukimin dhe trajnimin, Partneritetin Lindor të Bashkimit Evropian dhe Agjendën e Ballkanit Perëndimor të Bashkimit Evropian për inovacionin, kërkimin, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin,

Palët kontraktuese kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

1. Bashkëpunimi midis palëve kontraktuese në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin në lidhje me të, në veçanti bashkëpunimi dhe lëvizshmëria ndëruniversitare, do të promovohen në përputhje me këtë marrëveshje.

2. Bashkëpunimi i referuar në paragrafin 1, me përjashtim të bursave të studimit të referuara në nenin 2, paragrafët 6 dhe 7, do të arrihet në kuadrin e rrjeteve universitare të Programit të Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studimet Universitare, të përcaktuara në këtë marrëveshje.

3. Bursat e studimit të CEEPUS IV janë grante gjithëpërfshirëse që do të mbulojnë kostot e jetesës, shpenzimet për tarifat laboratorike sipas praktikës së përgjithshme në vendin pritës, në rastet e zbatueshme, si edhe akomodimin dhe sigurimin bazë shëndetësor, në rastet e zbatueshme, gjatë qëndrimit në vendin pritës. Bursat e studimit të CEEPUS IV do të jenë në raport me kostot e jetesës në vendin pritës përkatës dhe inflacionin e tij.

4. Gjithashtu, bursat e CEEPUS IV mund të jenë grante për shpenzimet, në lidhje me qëllimet e të mësuarit *online* dhe të mësuarit ose mësimdhënies hibride. Bursat e studimit virtual janë plotësuese të shkëmbimit fizik, sipas rregulloreve kombëtare dhe të përcaktuara në programin përkatës të punës së CEEPUS-it. Në këtë rast, bursat e studimit të CEEPUS IV nuk duhet të përdoren domosdoshmërisht për qëllimet e lëvizshmërisë.

5. Në bazë të kësaj marrëveshjeje nuk do të ketë asnjë transferim fondesh ndërmjet palëve kontraktuese. Bursat e studimit të CEEPUS IV financohen nga vendi pritës. Çdo grant shtesë për shpenzimet, në rastet e zbatueshme, do të financohet nga vendi i origjinës. Shtesat për shpenzimet mund të jenë fonde ekstra për shpenzimet e udhëtimit, përfitime për persona vulnerabël, të nënpërfaqësuar dhe me aftësi të kufizuara ose pagesa të tjera ekstra, në rastet e zbatueshme. Palët kontraktuese dhe universitetet pjesëmarrëse nxiten që të ofrojnë financim vullnetar shtesë për veprimtaritë e CEEPUS IV.

6. Sipas kësaj marrëveshjeje dhe rregullave të procedurës që do të miratohen nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave, palët kontraktuese do të shpallin muajt e bursës për bashkëpunim (“monedha CEEPUS” e brendshme) për secilin vit pasues akademik në intervale vjetore. Monedha minimale CEEPUS do të jetë njëqind muaj bursa studimi.

7. Bursat e studimit të CEEPUS IV nuk do të mbulojnë kostot ose shpenzimet administrative, në lidhje me qëllimet organizative ose administrative. Palët kontraktuese dhe universitetet pjesëmarrëse nxiten që të ofrojnë financim vullnetar shtesë për të mbuluar këto kosto ose shpenzime.

8. Muajt e bursave të studimit të CEEPUS IV mund të përdoren, gjithashtu, për mbledhjet e koordinimit të rrjetit të CEEPUS IV, në rastet e zbatueshme, dhe në bazë të programit përkatës të punës së CEEPUS-it.

Neni 2

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi “universitet” nënkupton një institucion që ofron arsim të lartë, i cili njihet nga autoriteti përgjegjës i një pale kontraktuese se i përket sistemit të tij të arsimit të lartë. Secila palë kontraktuese do të ofrojë një listë universitetesh, të cilat janë të pranueshme për veprimet e CEEPUS IV një herë në vit, përpara çdo thirrjeje të re për zbatimet e rrjetit.

2. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi “vit akademik” nënkupton periudhën nga data 1 shtator e një viti deri më 31 gusht e vitit pasardhës. Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik aktual mund të variojë sipas rregulloreve kombëtare të palëve kontraktuese.

3. Studentët e regjistruar në universitete, pavarësisht fushës së tyre të studimit, do të kenë mundësi të përfitojnë nga bursat e studimit të CEEPUS IV deri në dhe duke përfshirë nivelin e doktoratës. Periudha e studimit, trajnimin ose vendosjes duhet të kryhet në një universitet ose institucion pritës të një rrjeti të

CEEPUS-it, në përputhje me këtë marrëveshje dhe programin përkatës të punës së CEEPUS-it, me kusht që kreditet e fituara gjatë një periudhe studimi, trajnimi apo vendosjeje jashtë shtetit të njihen dhe jepen nga universiteti vendës i studentit përkatës. Një sipërmarrje tregtare, një subjekt kërkimor, një institucion qeveritar ose një organizatë tjetër në vendin pritës mund të shërbejë, gjithashtu, si një institucion pritës, nëse zbatohet dhe përcaktohet në programin përkatës të punës së CEEPUS-it.

4. Programi CEEPUS IV do të mbështesë lëvizshmërinë e anëtarëve të fakultetit, p.sh. personeli akademik, kërkimor dhe/ose artistik i një universiteti të caktuar, duke dhënë bursa studimi CEEPUS IV, me qëllim promovimin e bashkëpunimit transnacional ndëruniversitar dhe dimensionin e Evropës Qendrore të kurrikulave të universitetit, siç përcaktohen në programin e punës së CEEPUS-it.

5. Bursat e studimit të CEEPUS IV mund t'i jepen edhe personelit universitar të një universiteti pjesëmarrës në rrjetin e CEEPUS-it, me qëllim përforcimin e ndërtimit të kapaciteteve brenda rrjetit dhe ndihmën në organizimin e veprimtarive të përbashkëta midis partnerëve të rrjetit të CEEPUS IV, të përcaktuar në programin përkatës të punës së CEEPUS-it.

6. Muajt e pakonsumuar të bursës së studimit brenda rrjetit të CEEPUS, mund t'u jepen, gjithashtu, studentëve të regjistruar në një universitet të pranueshëm jashtë rrjetit të CEEPUS IV dhe anëtarëve të fakultetit ose personelit universitar të universiteteve të pranueshëm jashtë një rrjeti CEEPUS IV ("Lëvizësit e lirë"), të përcaktuar në programin përkatës të punës së CEEPUS-it dhe me kusht që të ekzistojnë masa të veçanta për studim, mësimdhënie, mbikëqyrje ose të mësuarit me bashkëmoshatarët në atë universitet.

7. Secila palë kontraktuese mund të pranojë dhe të njohë pjesëmarrjen e studentëve dhe mësuesve nga institucionet e arsimit të lartë nga palët jokontraktuese brenda veprimtarive të rrjetit të CEEPUS-it, sipas rregulloreve kombëtare dhe bazuar në vendimin individual të një pale kontraktuese. Palët kontraktuese mund të shpallin muaj shtesë bursash studimi për secilin vit pasues akademik për këto veprimtari, të cilat duhet të lidhen me zbatimin e veprimtarive të përshkruara në programin përkatës të punës.

Nëse Komiteti i Përbashkët identifikon unanimisht një interes të përbashkët për bashkëpunim me një palë jokontraktuese specifike, studentit dhe mësuesit nga institucionet e arsimit të lartë në atë palë të tretë mund të përfitojnë lëvizshmëri, me kusht që pala përkatëse kontraktuese të ketë muaj bursash studimi të pakonsumuar, në kuadër të rrjeteve të CEEPUS-it. Në rastet e zbatueshme, këta muaj bursash studimi të pakonsumuar mund të përdoren për lëvizshmëritë e studentëve dhe mësuesve të palës së tretë, siç përcaktohet në programin përkatës të punës së CEEPUS-it.

Neni 3

1. Nëpërmjet kësaj krijohet një komitet i përbashkët i ministrave, në vijim i referuar si Komiteti i Përbashkët", i përbërë nga një përfaqësues i secilës prej palëve kontraktuese, Komiteti i Përbashkët do të jetë përgjegjës për të gjitha masat dhe vendimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë miratimin e raporteve të vlerësimit. Të paktën çdo vit të dytë. Komiteti i Përbashkët do të miratojë një program pune për bashkëpunimin e CEEPUS IV.

2. Komiteti i Përbashkët do të mblidhet, siç çmohet e nevojshme, megjithatë, të paktën çdo dy vjet. Ai do të miratojë rregullat e veta të procedurës, Komiteti do të zgjedhë një prej anëtarëve të tij si Kryetar për dy vjet. Ai mund të ngrejë grupe pune të nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të vendosë për përbërjen e tyre.

3. Komiteti i Përbashkët do të bëjë çdo përpjekje për të arritur një konsensus rreth të gjitha vendimeve. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme dhe nuk është arritur asnjë konsensus, vendimet, si mjet i fundit, do të miratohen me një votim nga një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm të Komitetit të Përbashkët (personalisht ose *online*).

4. Komiteti i Përbashkët do të miratojë unanimisht vendime, në lidhje me shumën totale të muajve të bursave të CEEPUS IV, në përputhje me nenin 1, paragrafi 6.

Neni 4

1. Vendimet në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së rrjeteve të CEEPUS IV do të merren nga një grup pune i Komitetit të Përbashkët.

2. Secila palë kontraktuese do të ngrejë një komision kombëtar akademikësh dhe/ose ekspertësh të tjerë për të asistuar në procesin e përzgjedhjes së përmendur në paragrafin 1.

3. Secila palë kontraktuese do të ngrejë një Zyrë Kombëtare CEEPUS, e cila do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

a) të organizojë zbatimin e programit të CEEPUS-it, sipas rregulloreve përkatëse kombëtare dhe juridiksioneve financiare;

b) të promovojë dhe të informojë rreth programit, si dhe të shpërndajë rezultatin e bashkëpunimit në nivel kombëtar;

c) të këshillojë kërkuesit e mundshëm, në lidhje me bashkëpunimin e rrjetit dhe programin e bursave të studimit;

d) të marrë dhe të vlerësojë zyrtarisht aplikimet, si dhe të organizojë vlerësimin e rrjetit të ekspertëve në nivel kombëtar;

e) të japë dhe të përpunojë bursat e studimit në bazë të programit përkatës të punës dhe të rregulloreve kombëtare;

f) të organizojë pagesat, në lidhje me bursat e studimit që korrespondojnë me rregulloret kombëtare, si dhe në përputhje me juridiksionet përkatëse financiare të palës kontraktuese;

g) të veprojë si një këshilltar, duke informuar palën kontraktuese përkatëse mbi zhvillimet më të fundit të bashkëpunimit të CEEPUS-it;

h) të kryejë një vlerësim kombëtar mbi bashkëpunimin, në rastet e zbatueshme, dhe të kontribuojë në një vlerësim të përgjithshëm të bashkëpunimit;

i) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme së bashku me Zyrën Qendrore të CEEPUS-it, me qëllim pajtueshmërinë e plotë me Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Evropiane.

4. Palët kontraktuese do të njoftojnë Zyrën Qendrore CEEPUS mbi krijimin e Zyrës së tyre përkatëse Kombëtare të CEEPUS-it në Zyrën Qendrore të CEEPUS-it.

5. Zyrat Kombëtare të CEEPUS-it do të marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga Zyra Qendrore e CEEPUS-it.

6. Palët kontraktuese do të marrin masa për të siguruar se Zyra e tyre përkatëse Kombëtare e CEEPUS-it ka mjetet e kërkuara për përmbushjen e funksioneve të saj.

Neni 5

1. Një Zyrë Qendrore e CEEPUS-it themelohet me anë të kësaj në Vjenë. Zyra Qendrore e CEEPUS-it do të ketë zotësinë juridike të kërkuar për ushtrimin e funksioneve të saj.

2. Kreu i Zyrës Qendrore të CEEPUS-it është Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, me propozim të Republikës së Austrisë, do të zgjidhet për një periudhë prej shtatë vjetësh me dy të tretat e votave të shumicës të Komitetit të Përbashkët. Sekretari i Përgjithshëm mund të zëvendësohet përpara përfundimit të mandatit të tij me një vendim unanim të Komitetit të Përgjithshëm.

3. Infrastruktura e kërkuar për përmbushjen e funksioneve të Zyrës Qendrore të CEEPUS-it, duke përfshirë pagat e Sekretarit të Përgjithshëm dhe personelit të zyrës, do të financohet nga Republika e Austrisë.

4. Kostot për përfaqësuesit e palëve kontraktuese ose çdo personel i nënkontraktuar i Zyrës Qendrore të CEEPUS-it do të mbulohen nga pala kontraktuese përkatëse.

5. Palët kontraktuese nxiten të ofrojnë financime vullnetare të veprimtarive të Zyrës Qendrore të CEEPUS-it, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të bashkëpunimit.

6. Zyra Qendrore e CEEPUS-it do të ketë një funksion koordinues dhe vlerësues dhe palët kontraktuese do të kenë fuqi dhe kontroll të plotë mbi buxhetet kombëtare përkatëse për bashkëpunimin.

7. Në veçanti, Zyra Qendrore e CEEPUS-it do të:

a) njoftojë Komitetin e Përbashkët në mbledhjen e tij pasuese mbi njoftimet e marra në mënyrë intersesionale nga Sekretari i Përgjithshëm midis mbledhjeve të Komitetit të Përbashkët mbi çështje urgjente teknike dhe administrative;

- b) përgatisë një raport vjetor progresi dhe do të ndërmarrë vlerësimin e përgjithshëm të zbatimit të kësaj marrëveshjeje;
- c) dorëzojë propozime për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit;
- d) përgatisë dhe organizojë mbledhjet e Komitetit të Përbashkët dhe grupeve të punës dhe do të hartojë procesverbalet e mbledhjeve;
- e) mbështesë zbatimin e vendimeve të miratuara nga Komiteti i Përbashkët;
- f) zhvillojë një strategji të përbashkët në marrëdhëniet me publikun për bashkëpunimin dhe këshillimin e palëve kontraktuese për politikën e informacioneve;
- g) publikojë informacione mbi bashkëpunimin midis universiteteve pjesëmarrëse të palëve kontraktuese.

Neni 6

1. Palët kontraktuese, në përputhje me këtë marrëveshje, do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të shmangur kufizimet lidhur me lëvizjen e lirë dhe të banimit të individëve të cilët përfitojnë një bursë studimi CEEPUS IV.

2. Palët kontraktuese do të marrin masat e duhura në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, me qëllim heqjen e pengesave administrative dhe financiare për të mundësuar zbatimin e plotë të bashkëpunimit.

Neni 7

Përpara përfundimit të vitit të katërt akademik pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, Komiteti i Përbashkët do të kryejë një rishikim të kësaj marrëveshjeje. Ky rishikim do të bazohet në një vlerësim të përgjithshëm të bashkëpunimit.

Neni 8

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese ose ndërmjet palëve kontraktuese dhe Zyrës Qendrore të CEEPUS-it, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje ose programit të punës, do të zgjidhet nëpërmjet negociatave dhe konsultimeve në mirëbesim ndërmjet palëve në mosmarrëveshje. Çdo mosmarrëveshje, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet këtyre negociatave dhe konsultimeve, do të zgjidhet me mirëkuptim nga Komiteti i Përbashkët. Për këtë qëllim, Komiteti i Përbashkët do të ngrejë një grup pune, në përputhje me nenin 3, paragrafi 2, të kësaj marrëveshjeje. Grupi i punës mund të marrë rekomandime nga Komiteti i Përbashkët për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse një mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese nuk mund të zgjidhet nga Komiteti i Përbashkët, secila prej palëve kundërshtuese mund të kërkojë arbitrazh.

2. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre anëtarë. Secila prej palëve në mosmarrëveshje do të caktojë një arbitër. Të dy këta arbitra do të emërojnë së bashku një arbitru të tretë, i cili do të veprojë si kryetar i gjykatës.

3. Gjykata e arbitrazhit do të vendosë selinë e saj dhe do të miratojë rregullat e veta të procedurës.

4. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit do të merret me një shumicë votash të anëtarëve të saj. Anëtarët e gjykatës së arbitrazhit nuk mund të abstenojnë në votim. Vendimi do të jetë i formës së prerë dhe detyrues ndaj të gjitha palëve në mosmarrëveshje dhe nuk do të ketë asnjë apelim. Palët në mosmarrëveshje do të pajtohen pa vonesë me vendimin. Në rast mosmarrëveshjeje, për sa i përket kuptimit ose fushës së tij të veprimit, gjykata e arbitrazhit, nëse është e nevojshme, me shumicë votash do të interpretojë vendimin me kërkesë të cilësdo palë të mosmarrëveshjes.

Neni 9

1. Kjo marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha palët kontraktuese të marrëveshjes CEEPUS III.

2. Kjo marrëveshje do t'i nënshtrohet miratimit nga Shtetet Nënshkruese në përputhje me procedurat e tyre kombëtare përkatëse. Instrumentet/dokumentet e miratimit do të depozitohen pranë Zyrës Qendrore të CEEPUS-it, si Depozitar i kësaj marrëveshjeje.

3. Depozitari do t'i informojë të gjitha palët kontraktuese mbi njoftimet dhe instrumentet e miratimit të marrë.

4. Dokumenti original i kësaj marrëveshjeje do të depozitohet pranë Depozitarit.

Neni 10

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi më 1 maj 2025, pasi Shtetet Nënshkruese të kenë depozituar instrumentin e tyre të miratimit. Nëse janë dorëzuar më pak se tri instrumente miratimi deri në atë datë, marrëveshja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të tretë të miratimit. Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një periudhë prej shtatë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi.

2. Për Shtetet nënshkruese që depozitojnë instrumentin e tyre të miratimit pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 10, paragrafi 1, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës kur është depozituar instrumenti i miratimit.

3. Secila palë kontraktuese mund të propozojë në çdo kohë një rishikim të kësaj marrëveshjeje. Ky rishikim do të dorëzohet me shkrim te Kryetari i Komitetit të Përbashkët dhe palët e tjera kontraktuese të paktën gjashtë javë përpara mbledhjes së Komitetit të Përbashkët, nëse nuk vendoset ndryshe nga Komiteti i Përbashkët. Vendimet në lidhje me rishikimin e kësaj marrëveshjeje do të miratohen unanimisht nga Komiteti i Përbashkët. Rishikimi do t'i nënshtrohet nënshkrimit dhe miratimit nga palët kontraktuese, në përputhje me procedurat e tyre kombëtare përkatëse. Instrumentet e miratimit do të depozitohen pranë Depozitarit. Rishikimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të tretë të miratimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në rishikim.

Neni 11

1. Marrëveshja do të mbetet e hapur për aderim të shteteve jo palë kontraktuese të marrëveshjes CEEPUS III, me një vendim unanim të Komitetit të Përbashkët. Shtetet që synojnë të aderojnë në këtë marrëveshje do të njoftojnë Depozitarin me shkrim. Depozitari do të informojë palët e tjera kontraktuese mbi synimin e shtetit për të aderuar në këtë Marrëveshje.

2. Instrumentet e aderimit do të depozitohen në Zyrën Qendrore të CEEPUS-it. Depozitari do të informojë palët kontraktuese mbi instrumentet e depozituara të aderimit.

3. Për një Shtet që aderon në këtë marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit.

4. Shtetet të cilat kanë aderuar në këtë marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, do të marrin pjesë në veprimtaritë e CEEPUS IV, të përcaktuara në programin e punës dhe në përputhje me vendimet e Komitetit të Përbashkët.

Neni 12

Secila palë kontraktuese mund të tërhiqet në çdo kohë nga kjo marrëveshje me një njoftim paraprak me shkrim të dërguar Depozitarit. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi gjashtë muaj nga data e marrjes së njoftimit të tërheqjes nga Depozitari.

Tërheqja e një pale kontraktuese nuk do të ndikojë në rrjetet, veprimet dhe veprimtaritë e filluara përpara hyrjes në fuqi të tërheqjes në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

Palët kontraktuese njohin rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe do të marrin masa efektive për të zbatuar standardet e duhura të privatësisë brenda Programit të Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studimet Universitare.


Palët kontraktuese bien dakord se këto standarde privatësie për CEEPUS IV do të jenë në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave dhe rregulloret e tjera vijuese.

Hartuar në Varshavë, Poloni, më xx.xx.xxxx, në një kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Republikën e Shqipërisë
Për Republikën e Austrisë
Për Republikën e Bullgarisë
Për Bosnjë dhe Hercegovinën
Për Republikën e Kroacisë
Për Republikën Çeke
Për Hungarinë
Për Republikën e Moldavisë
Për Malin e Zi
Për Republikën e Maqedonisë së Veriut
Për Republikën e Polonisë
Për Rumaninë
Për Republikën e Serbisë
Për Republikën Sllovaqe
Për Republikën e Sllovenisë

Agreement

concerning the
Central European Exchange Programme
for University Studies
(„CEEPUS IV“)



The CEEPUS contracting parties share the following vision:

- the pursuit of truth, the fundamental role of science in the creation of civilization and the transmission of knowledge from generation to generation as a particularly honourable human activity,
- regional academic exchange as an important instrument to overcome mutual stereotypes,
- long-term academic collaboration through high-quality topic-specific university networks by providing the appropriate framework for the mobility of students, doctoral students, researchers, academic teachers, and university staff,
- advancements in the recognition of study abroad periods as well as the higher education qualifications between universities and fostering the development of the Central European dimension of university curricula,
- promotion of regional collaboration in the field of higher education within the framework of the Central European Exchange Programme for University Studies hereinafter referred to as “CEEPUS IV”.

The contracting parties have committed to:

- the key role that higher education plays in meeting the United Nations Sustainable Development Goals,
- the goals of the Bologna Process and its relevant Communiqués, therefore contributing to the further realization of the European Higher Education Area

and take note of:

- the European Education Area Strategic Framework for education and training, the European Union Eastern Partnership, and the European Union Western-Balkans agenda on innovation, research, education, culture, youth & sport.

The contracting parties have agreed as follows:

Article 1

- 1)** The cooperation among contracting parties in the field of higher education and related research, in particular inter-university cooperation and mobility, shall be promoted in accordance with this agreement.

- 2)** The cooperation referred to in paragraph 1 shall, with the exception of scholarships referred to in Article 2 paragraph 6 and paragraph 7, be accomplished in the framework of university networks of the Central European Exchange Programme for University Studies, as defined in this agreement.

- 3)** CEEPUS IV scholarships are comprehensive grants which shall cover living costs, expenses for laboratory fees according to general practice in the host country, where applicable, as well as housing and basic medical insurance, where applicable, during the stay in a host country. CEEPUS IV scholarships shall be commensurate with living costs in the respective host country and its inflation.

- 4)** Furthermore, CEEPUS IV scholarships can also be grants for expenses related to purposes of e-learning, e-teaching, and hybrid learning or teaching. Virtual scholarships are complementary to physical exchange according to national regulations and as defined in the respective CEEPUS work programme. In that case, CEEPUS IV scholarships do not necessarily have to be used for mobility purposes.

- 5)** There shall be no transfer of funds among contracting parties under this agreement. CEEPUS IV scholarships are financed by the host country. Any additional top-ups for outgoings shall, where applicable, be financed by the country of origin. Top-ups for outgoings can be extra funds for travel expenses, benefits for vulnerable, underrepresented, or disabled people or other extra payments, where applicable. Contracting parties and participating universities are encouraged to provide additional voluntary funding for CEEPUS IV activities.
- 6)** In accordance with this agreement and the rules of procedure to be adopted by the Joint Committee of Ministers, contracting parties shall announce the scholarship months for the cooperation (the internal “CEEPUS currency”) for each following academic year in annual intervals. The minimum CEEPUS currency shall be one hundred scholarship months.
- 7)** CEEPUS IV scholarships shall not cover overhead costs or expenses related to organisational or administrative purposes. Contracting parties and participating universities are encouraged to provide additional voluntary funding to cover these costs or expenses.
- 8)** CEEPUS IV scholarship months may also be used for coordination meetings of CEEPUS IV networks, where applicable and as defined in the respective CEEPUS work programme.

Article 2

1) For the purposes of this agreement, the term “university” means an institution providing higher education which is recognized by the responsible authority of a contracting party as belonging to its system of higher education. Each contracting party shall provide a list of universities that are eligible for CEEPUS IV actions once a year before each new call for network applications.

2) For the purposes of this agreement, the term “academic year” means the period from 1st September of one year until 31st August of the following year. The beginning and the end of the actual academic year may vary according to national regulations of the contracting parties.

3) Students registered at universities, regardless of their field of study, shall be eligible for CEEPUS IV scholarships up to and including the doctoral level. The period of study, training, or placement has to be performed at a host university or a host institution of a CEEPUS network in accordance with the present agreement and the respective CEEPUS work programme, provided that the credits earned during a period of study, training or placement abroad are recognized and granted by the home university of the respective student.

A commercial enterprise, a research facility, a governmental institution, or another organisation in the host country can also serve as a host institution where applicable and as defined in the respective CEEPUS work programme.

4) The CEEPUS IV programme shall support the mobility of faculty members, i.e., the teaching, research and/or artistic staff of a given university, by granting CEEPUS IV scholarships in order to promote transnational inter-university cooperation and the Central European dimension of university curricula as defined in the CEEPUS work programme.

5) CEEPUS IV scholarships may also be granted to university staff of a university taking part in a CEEPUS network, to enhance capacity building within the network and to help organise joint activities between CEEPUS IV network partners as defined in the respective CEEPUS work programme.

6) Scholarship months not consumed within the CEEPUS networks may also be granted to students enrolled at an eligible university outside a CEEPUS IV network and to faculty members or university staff of eligible universities outside a CEEPUS IV network (“Freemovers”) as defined in the respective CEEPUS work programme and provided that special arrangements for studying, teaching, supervising, or peer learning at such a university exist.

7) Each contracting party can accept and recognize the participation of students and teachers from higher education institutions from non-contracting parties within CEEPUS network activities according to national regulations and based on the individual decision of a contracting party. Contracting parties may announce extra scholarship months for each following academic year for these activities, which must be linked to the implementation of the activities described in the respective work programme.

If the Joint Committee unanimously identifies a common interest for cooperation with a specific non-contracting party, students and teachers from higher education institutions in such a third-party may be awarded mobilities, provided that the respective contracting party has unconsumed scholarship months in the frame of the CEEPUS networks. Where applicable, such unconsumed scholarship months can be used for the third-party students’ and teachers’ mobilities as defined in the respective CEEPUS work programme.

Article 3

- 1)** A joint committee of ministers, hereinafter “Joint Committee”, composed of one representative of each of the contracting parties, is hereby established. The Joint Committee shall be responsible for all measures and decisions necessary to ensure the implementation of this agreement, including the approval of evaluation reports. At least every second year the Joint Committee shall adopt a work programme for the CEEPUS IV cooperation.
- 2)** The Joint Committee shall meet as considered necessary, however, at least every second year. It shall adopt its own rules of procedure. The Committee shall elect one of its members as Chairperson for two years. It may establish working groups required for the implementation of this agreement and decide on their composition.
- 3)** The Joint Committee shall make every effort to reach a consensus about all decisions. If all possible efforts have been exhausted and no consensus has been reached, decisions shall as a last resort be adopted by a two-thirds majority vote of the Joint Committee’s present members (in person or online).
- 4)** The Joint Committee shall unanimously adopt decisions regarding the total amount of CEEPUS IV scholarship months in accordance with Article 1 paragraph 6.

Article 4

- 1)** Decisions concerning the procedure for the selection of CEEPUS IV networks shall be made by a working group of the Joint Committee.

- 2)** Each contracting party shall establish a national commission of academics and/or other experts to assist in the selection process mentioned in paragraph 1.

- 3)** Each contracting party shall establish a National CEEPUS Office which shall have the following responsibilities:
 - a. Organizing the implementation of the CEEPUS programme according to the respective national regulations and financial jurisdictions.
 - b. Promoting of and informing about the programme and disseminating the outcome of the cooperation on a national level.
 - c. Advising potential applicants regarding the network cooperation and the scholarship programme.
 - d. Receiving and formally evaluating applications and organizing the experts' network assessment on a national level.
 - e. Awarding and processing of scholarships according to the respective work programme and the national regulations.
 - f. Organizing payments in connection with scholarships corresponding with national regulations and in accordance with the respective financial jurisdictions of the contracting party.
 - g. Acting as an advisor by informing the respective contracting party of the latest developments of the CEEPUS cooperation.
 - h. Conducting a national evaluation of the cooperation, where applicable, and contributing to the overall evaluation of the cooperation.
 - i. Taking necessary measures and actions together with the Central CEEPUS Office to fully comply with the European Data Protection Regulation.

- 4) The contracting parties shall notify the establishment of their respective National CEEPUS Office to the Central CEEPUS Office.
- 5) The National CEEPUS Offices shall participate in meetings arranged by the Central CEEPUS Office.
- 6) The contracting parties shall take measures to ensure that their respective National CEEPUS Office has the means required for the fulfilment of its functions.

Article 5

- 1) A Central CEEPUS Office is hereby established in Vienna.
The Central CEEPUS Office shall have such legal capacity as is required for the exercise of its functions.
- 2) The head of the Central CEEPUS Office is the Secretary General. The Secretary General shall, upon a proposal by the Republic of Austria, be elected for a period of seven years by a two-thirds majority vote of the Joint Committee. The Secretary General may be replaced before the end of their term by unanimous decision of the Joint Committee.
- 3) The infrastructure required for the fulfilment of the Central CEEPUS Office's functions, including the salaries of the Secretary General and the staff of the office, shall be financed by the Republic of Austria.
- 4) The costs for representatives of the contracting parties or any personnel seconded to the Central CEEPUS Office shall be covered by the respective contracting party.
- 5) The contracting parties are encouraged to provide voluntary funding for activities of the Central CEEPUS Office to further improve the implementation of cooperation.
- 6) The Central CEEPUS Office shall have a coordinating and evaluating function and the contracting parties shall retain full power and control over their respective national budgets for the cooperation.

7) The Central CEEPUS Office shall in particular:

- a. Notify the Joint Committee at its next meeting about decisions taken intersessionally by the Secretary General between meetings of the Joint Committee on urgent technical and administrative matters.
- b. Prepare an annual progress report and undertake the overall evaluation of the implementation of this agreement.
- c. Submit proposals for further development of the cooperation.
- d. Prepare and organise the meetings of the Joint Committee and the working groups and produce meeting minutes.
- e. Support the implementation of decisions adopted by the Joint Committee.
- f. Develop a joint public relations strategy for the cooperation and advise the contracting parties on information policies.
- g. Publish information on the cooperation among participating universities of the contracting parties.

Article 6

- 1)** The contracting parties shall, in accordance with this agreement, make all efforts to avoid restrictions concerning the free movement and residence of individuals receiving a CEEPUS IV scholarship.
- 2)** The contracting parties shall take appropriate measures in accordance with their national laws in order to eliminate administrative and financial obstacles to enable the full implementation of the cooperation.

Article 7

A review of this agreement by the Joint Committee shall be completed before the end of the fourth academic year after the agreement takes effect.
Such a review shall be based on an overall evaluation of the cooperation.

Article 8

- 1)** Any dispute between the contracting parties or between the contracting parties and the Central CEEPUS Office concerning the interpretation or application of this agreement, or the work programme shall be settled through good faith negotiations and consultations between the disputing parties. Any dispute which cannot be settled through such negotiations and consultations shall be settled amicably by the Joint Committee. For this purpose, the Joint Committee may establish a working group in accordance with Article 3 paragraph 2 of this agreement. The working group may make recommendations to the Joint Committee for the settlement of the dispute. If a dispute between the contracting parties cannot be settled by the Joint Committee, any disagreeing party to the dispute may call for arbitration.
- 2)** The arbitration tribunal shall consist of three members. Each party to the dispute shall nominate one arbitrator. These two arbitrators shall nominate the third arbitrator, who shall act as the chairperson of the tribunal.
- 3)** The arbitration tribunal shall decide its seat and adopt its own rules of procedure.
- 4)** The award of the arbitration tribunal shall be decided by a majority vote of its members. Members of the arbitration tribunal may not abstain from a vote. The award shall be final and binding on all parties to the dispute and no appeal may be made. The parties to the dispute shall comply with the award without delay. In the event of a dispute as to its meaning or scope, the arbitration tribunal shall, if necessary, by majority vote interpret the award at the request of any party to the dispute.

Article 9

- 1)** This agreement shall be open for signature by all the contracting parties of the CEEPUS III agreement.
- 2)** This agreement shall be subject to approval by the Signatory States in accordance with their respective national procedures.
The instruments of approval shall be deposited with the Central CEEPUS Office as the Depositary of this agreement.
- 3)** The Depositary shall inform all the contracting parties of notifications and instruments of approval received.
- 4)** The original of this agreement shall be deposited with the Depositary.

Article 10

- 1)** This agreement shall take effect on May 1, 2025, after Signatory States have deposited their instrument of approval. If fewer than three instruments of approval have been deposited by that date, the agreement takes effect on the first day of the third month following the deposit of the third instrument of approval. The agreement shall remain in force for a period of seven years from the date of its entry into force.
- 2)** For Signatory States depositing their instrument of approval after this agreement has taken effect according to Article 10 paragraph 1, this agreement shall take effect on the first day of the month following the day on which the instrument of approval has been deposited.
- 3)** Each contracting party may at any time propose a revision of this agreement. Such a revision shall be submitted in writing to the Chairperson of the Joint Committee and the other contracting parties at least six weeks before a meeting of the Joint Committee unless decided otherwise by the Joint Committee. Decisions concerning a revision of this agreement shall be adopted by the Joint Committee unanimously. The revision shall be subject to signature and to approval by the contracting parties in accordance with their respective national procedures. The instruments of approval shall be deposited with the Depositary. The revision enters into force on the first day of the third month following the deposit of the third instrument of approval, unless otherwise provided in the revision.

Article 11

- 1)** This agreement shall remain open for accession by states other than the contracting parties of the CEEPUS III agreement upon unanimous decision of the Joint Committee. States intending to accede to this agreement shall notify the Depositary in writing. The Depositary shall inform the other contracting parties of a state's intention to accede to this agreement.
- 2)** Instruments of accession shall be deposited with the Central CEEPUS Office. The Depositary shall inform contracting parties of the deposited instruments of accession.
- 3)** For a State acceding to this agreement after its entry into force, this agreement shall enter into force on the first day of the month following the deposit of its instrument of accession.
- 4)** States which have acceded to this agreement after its having taken effect, shall participate in CEEPUS IV activities as set out in the work programme and in accordance with the decisions of the Joint Committee.

Article 12

Each contracting party may at any time withdraw from this agreement by prior written notification to the Depositary. Such withdrawal shall take effect six months from the date of receipt by the Depositary of the notification of withdrawal.

Withdrawal of a contracting party shall not affect the networks, actions and activities commenced on the basis of this agreement before the withdrawal has become effective.

Article 13

The contracting parties acknowledge the importance of data protection and shall take effective measures to implement appropriate privacy standards within the Central European Exchange Programme for University Studies.

The contracting parties agree that these privacy standards for CEEPUS IV shall be in accordance with the European General Data Protection Regulation and its successive regulations.

Done at Warsaw, Poland, on September 20, 2023 in one original in the English language.

For the Republic of Albania

Almo Topi

For the Republic of Austria

Werner Stiller 06.10.2023

For Bosnia and Herzegovina

Dr. Mirko Topić

For the Republic of Bulgaria

Georgi Stoyanov

For the Republic of Croatia

Stjepan Pinterić

For the Czech Republic

Michal Šmehl

For Hungary

Attila Horváth

For the Republic of Moldova

Stefan Ursu

For Montenegro

Dragan Radulović, Vienna, Nov. 9, 2023

For the Republic of North Macedonia

Stefan Pivovarov

For the Republic of Poland

Grzegorz Schramm

For Romania

Florin Cîțu

For the Republic of Serbia

Marko Purić

For the Slovak Republic

Michal Šmehl

For the Republic of Slovenia

Robert Golob

Certified a true and complete copy of the sole original document in English
deposited in the archives of the Central CEEPUS Office

Vienna, November 9, 2023

The Secretary General of the CEEPUS Programme


Michael SCHEDL

